



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 8849, Prot.

Tiranë, më 7/5.2018

URDHËR

Nr. 143, Datë 7/5/2018

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT
TË FONDIT NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË REJA “START-UP

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 210, datë 20.04.2018 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-Up”

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullosës së Funkcionimit të Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-Up, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT

FONDI NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË REJA “START-UP”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	3
2. Informacion i Përgjithshëm.....	3
2.1. Kriteret e Aplikimit.....	4
2.2. Financimi Maksimal.....	5
2.3. Kosto që mund të mbulohen nga Fondi.....	5
2.4. Kostot që nuk mbulohen nga Fondi.....	5
2.5. Përgjegjësitë e përfituesve.....	6
3. Aplikimi.....	6
4. Monitorimi.....	7
4.1. Raportet mbi Projektin e Ndërmarrjes.....	7
5. Procedura e Pagesës.....	8
6. Konfidencialiteti i të dhënave.....	8
7. Menaxhimi i Fondit.....	9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

1. Hyrje

Kjo rregullore miratohet në zbatim të VKM-së Nr. 210, datë 20.04.2018 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-Up”” dhe përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente Fondin në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”.

Qëllimi i fondit është: *Mbështetja e bizneseve të sapokrijuara “Start-Up” në Shqipëri, nëpërmjet subvencionimit financiar të drejtpërdrejtë për këtë kategori biznesi me qëllim përmirësimin e klimës dhe kushteve operuese të tyre, duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.*

Me termin “sipërmarrje e re” ose “start Up” do të kuptohet një kompani e sapo krijuar dhe në kërkim të tregjeve.

2. Informacion i Përgjithshëm

Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up” është krijuar për t’i shërbyer Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla që ushtrojnë aktivitetin e tyre në:

- a) Sektorët prodhues dhe të shërbimit;
- b) Sektorin e industrisë së lehtë;
- c) Sektorin e turizmit;
- ç) Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- d) Procesin e agropërpunimit;
- dh) Fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

Fondi ofron subvencionim për shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitete të miratuara mbi bazën e ndarjes së shpenzimeve. Kjo nënkupton se granti nuk financon gjithë shpenzimet, por vetëm një pjesë të tyre, ndërkohë që pjesa tjetër financon nga përfituesi i grantit (në këtë rast ndërmarrja shqiptare).

Qëllimi i grantit nuk është zëvendësimi i asaj që ndërmarrja do të financonte me burimet e saj, por t’i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për NMV-të për të rritur konkurrueshmërinë e tyre. Kjo Skemë Granti bën të mundur që NMV-të përfituese të arrijnë më shumë nga sa ato do të mund të arrinin vetëm me mjetet e tyre.

Fondi mund të ketë si burim financimi dhe të ardhura nga donatorë apo institucione ndërkombëtare. Në këtë rast rregullat për përfitimin nga fondi do të vendosen në marrëveshje midis AIDA-s dhe donatorëve apo institucioneve ndërkombëtare.

